

**AKTI I THEMELIMIT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
Barbaka Boutique Hotel**

**Neni 1
Emërtimi**

1.1 Emërtimi i Shoqërisë është **Barbaka Boutique Hotel**, (në vijim "Shoqëria").

**Neni 2
Selia**

2.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: **Rruga Gjin Bue Shpata, godina av. Vjetër, Hyrja 7, Ap.34, Tiranë, Shqipëri**

**Neni 3
Objekti i Shoqërisë**

3.1 Shoqëria ka si objekt veprimitarje si më poshtë vijon:

- **Investime në fushën e hotelerisë dhe turizmit, hapjen e bareve dhe restoranteve. Investime në fushën e ndërtimit. Ofrim i shërbimeve në fushën e turizmit e hotelerisë, akomodim me qëllim pushimi apo biznesi nga shtetas shqiptar dhe të huaj, agjenci turistike, bar, restorante, akomodim në çadra plazhi, shezllona etj. Ofrim shërbimi për bar, restoran, turizëm, organizim eventesh dhe konferencash. Shërbim parkimi. Shoqëria do të ushtrojë çdo aktivitet ndihmës në përputhje me legjislacionin shqiptar i cili i shërben aktivitetit të saj kryesor. Blerja, shitja, shkëmbimi apo kalimi në çfarëdolloj mënyre tjetër të lejuar nga ligji i pasurive të paluajtshme apo të drejtave reale të lidhura me to, qofshin ekzistuese apo të ardhshme, të krijuara rishtazi apo të fituara nga të tjerë, dhënia me qira, huapërdorje, uzufrukt apo kalimi në çfarëdolloj mënyre tjetër të lejuar nga ligji i të drejtës posedimore të pasurive të paluajtshme apo të drejtave reale të lidhura me to. Pjesëmarrja në investime industriale e tregtarë. Shitja dhe blerja e kuotave/akSIONeve te shoqërive të tjera. Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër biznesi, i cili nuk është i ndaluar nga ligji**

3.2 Në përputhje me legjislacionin shqiptar, në mënyrë që të arrihet qëllimi i sipërpërmendur, Shoqëria mund:

- a. të kryejë çdo lloj aktiviteti në raport me objektin dhe për të favorizuar atë.
- b. të kryejë çdo transaksion në lidhje me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe çdo aktivitet tregtar, financiar, dhënie-marrje me qira, të vendosë pengje dhe barrë hipotekore që mund të konsiderohen si të dobishme apo të nevojshme për të arritur qëllimet e Shoqërisë dhe qe nuk tejkalojnë në masë aktivitetet kryesore, të cituara më sipër;
- c. të kryejë çdo aktivitet në lidhje me publikimin, marketingun apo reklamimin;

Neni 4
Kohëzgjatja

4.1 Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë pa afat.

Neni 5
Kapitali themeltar

- 5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është Lek **2,400,000**.
- 5.2. Kapitali themeltar i Shoqërisë përbëhet nga 1 (një) kuotë, e nënshkruar në shumën **2,400,000 lekë (dy milion e katërqind mijë) lekë** që përfaqëson 100% (njëqind për qind) të kapitalit të shoqërisë.

Neni 6
Kontributet

6.1 Kontributi në kapitalin e Shoqërisë është ofruar nga personat dhe në shumat si më poshtë:

- **Ilir Hoxha**, shtetas shqiptar, lindur më 18.04.1951, në Pogradec, mbajtës i letërnjoftimit me numër 037081439 dhe numër personal F10418102P, me adresë në: Rruga "Kongresi Lushnjes", P. 39, Shk. 4, Ap. 41, Tiranë, zotëron një kuotë në kapitalin e Shoqërisë, me vlerë të barabartë me kontributet e nënshkruara në shumën 800,000 lekë, të cilat përfaqësojnë **33.34%** të kapitalit të Shoqërisë;
- **Ervis Morina**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 18.02.1976, mbajtës i letërnjoftimit me numër 034186658 dhe numër personal H60218145D me adresë në: Bulevardi Gjergj Fishta, Pallati G&P kati përdhe (Coco Bar) Tiranë, zotëron një kuotë në kapitalin e Shoqërisë, me vlerë të barabartë me kontributet e nënshkruara në shumën prej 800,000 lekë, të cilat përfaqësojnë **33.33%** të kapitalit të Shoqërisë;
- **Klodian Marku**, shtetas shqiptar, lindur në Troshan, më 20.11.1979, mbajtës i letërnjoftimit me numër 039301006 dhe numër personal H91120058N me adresë në: Rruga Tish Daija, Nd. 1, H. 9, Ap. 39, zotëron një kuotë në kapitalin e Shoqërisë, me vlerë të barabartë me kontributet e nënshkruara në shumën prej 800,000 lekë, të cilat përfaqësojnë **33.33%** të kapitalit të Shoqërisë;

Neni 7
Transferimi i kuotave

7.1 Kuotat i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit.

Neni 8
Administratori/ët



- 8.1 Me këtë akt emërohet si Administrator i Shoqërisë për një afat 5 (pesë) vjeçar personi si më poshtë:

Ilir Hoxha, shtetas shqiptar, lindur më 18.04.1951, në Pogradec, mbajtës i letërnjoftimit me numër 037081439 dhe numër personal F10418102P, me adresë në Rruga "Kongresi Lushnjes", P. 39, Shk. 4, Ap. 41, Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar.

- 8.2 Kompetencat e Administratorit përcaktohen në Statutin e Shoqërisë.

Neni 9
Kontakti i shoqërisë

- 9.1 Email-i i shoqërisë është: **avanntive@avanntive.al**
9.2 Numri i kontaktit të shoqërisë është **0672044863**

Neni 10
Kopjet


- 10.1 Ky Akt Themelimi është bërë në 3 (tre) kopje me vlerë të njëjtë secila.

ORTAKËT

ILIR HOXHA



ERVIS MORINA



KLODIAN MARKU



Datë **[18 shtator 2024]**